

KOMBET E BASHKUARA

E



**Këshilli
Ekonomik dhe Social**

Për Përdorim të Përgjithshëm

CEP/AC.13/2005/3/Rev.1
23 Mars 2005

originali në Anglisht/ Frëngjisht/ Rusisht

KOMISIONI EKONOMIK PËR EVROPËN

KOMITETI PËR POLITIKAT MJEDISORE

Takim i nivelit të lartë të Ministrive të Mjedisit dhe të Arsimit
(Vilnius, 17-18 Mars 2005)
(Elementët përbërës të programit 5 dhe 6)

STRATEGJIA E UNECE PËR EDUKIM DHE ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM

Miraturar nga takimi i nivelit të lartë

translated and published by



REGIONAL ENVIRONMENTAL CENTER
Albania

Vizioni

Vizioni ynë i së ardhmes është ai i një vendi, që përfaqon vlerat e përbashkëta të solidaritetit, barazisë dhe respektit reciprok midis njerëzve, vendeve dhe brezave. Është një vend që karakterizohet nga zhvillim i qëndrueshëm, duke përfshirë këtu edhe vitalitetin ekonomik, drejtësinë, kohezionin shoqëror, mbrojtjen e mjedisit dhe manaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore për të përmbushur nevojat e brezit të tanishëm duke mos rrezikuar mundësitë e brezit të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tij¹.

Edukimi, përveç se është një prej të drejtave të njeriut², është një kusht paraprak për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe një mjet kryesor për një qeverisje të mirë, informimin rreth vendimmarrjes dhe mbështetjen e demokracisë. Për këtë arsye, edukimi për zhvillimin e qëndrueshëm mund të ndihmojë për ta kthyer vizionin tonë në realitet. Edukimi për zhvillimin e qëndrueshëm zhvillon dhe forcon kapacitetet e individëve, të grupeve, komuniteteve, organizatave dhe vendeve për të gjykuar dhe bërë zgjedhje në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm. Ai mund të nxisë ndryshimin e këndvështrimit të njerëzve për një botë më të sigurt, më të shëndetshme dhe më të begatë, duke përmirësuar në këtë mënyrë cilësinë e jetës. Edukimi për zhvillimin e qëndrueshëm mund të shërbejë si mendim kritik dhe më shumë informacion e ndërgjegjësim për të zbuluar vizione dhe koncepte të reja dhe për të zhvilluar metoda dhe mjete të reja.

Hyrje

1. Mandati për zhvillimin e Strategjisë bazohet në deklaratën e bërë nga ministrat e mjedisit të UNECE në konferencën e tyre të pestë “Mjedisi për Europën” (Kiev, Maj 2003). Strategjia ka përfituar nga përvoja e fituar në shkallë rajonale dhe atë botërore. Ajo përbën kontribut dhe është në përputhje me kuadrin e zbatimit të skemës paraprake të aktiviteteve për dhjetëvjeçarën e Kombeve të Bashkuara të Edukimit për Zhvillimin e Qëndrueshëm, e përgatitur nga Organizata për Kulturën, Shkencën dhe Arsimin e Kombeve të Bashkuara (UNESCO) dhe duhet përdorur si themeli për zbatimin rajonal të kësaj strategjie dhjetëvjeçare dhe përfundimeve të Samitit Botëror për Zhvillimin e Qëndrueshëm.

2. Strategjia është hartuar nëpërmjet një procesi pjesëmarrës, duke përfshirë qeveritë, institucionet edukative, OJFtë dhe aktorë të tjerë të rajonit të UNECE si dhe organizatat ndërkombëtare.

3. Kjo strategji duhet të ndihmojë në futjen dhe përkrahjen e edukimit për zhvillimin e qëndrueshëm (EZHQ) në rajonin e UNECE dhe në këtë mënyrë të kontribuojë në realizimin e vizionit tonë të përbashkët.

4. Rajoni i UNECE përfshin vende me shumëllojshmëri të madhe kulturore dhe kushte të ndryshme socio – ekonomike e politike. E ardhmja e zhvillimit të qëndrueshëm varet shumë prej ndryshimit të stilit të jetesës dhe mënyrave të konsumit

¹ Shiko gjithashtu Komisioni European për Mjedisin dhe Zhvillim, “E ardhmja jonë e përbashkët”, 1987

² Shiko gjithashtu “Formulimi mbi Edukimin për Zhvillimin e Qëndrueshëm” Konferenca e 5të Ministrore “Mjedisi për Europën”, Kiev, 2003
GE.05-30837

dhe prodhimit, duke respektuar njëkohësisht edhe nevojat e vendeve ku zbutja e varfërisë përbën akoma një shqetësim kryesor.

5. Rajoni ka parakushtet dhe nevojat për zbatimin e strategjisë. Shumë vende të rajonit kanë sisteme edukimi me mësues profesionistë të punësuar, kanë siguruar mundësinë për të marrë edukimin bazë dhe kanë garantuar të drejtën e edukimit për të gjithë, kanë arritur nivele të larta të arsimit të popullësisë, kanë zhvilluar një potencial shkencor dhe kanë siguruar pjesëmarrjen e shoqërisë civile. Gjithsesi, mbeten ende sfida për t'i përballuar në mënyrë që EZHQ të zbatohet në mënyrë sa më efektive. Kështu, duhen përmirësuar sistemet e edukimit për të trajtuar drejt natyrën ndërdisiplinore të EZHQ, duhet forcuar përfshirja e shoqërisë civile, duhen përfshirë institucionet e duhura dhe duhen mbështetur me mjetet përkatëse.

I. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

6. Qëllimi i strategjisë është të përkrahë shtetet anëtare të UNECE për të zhvilluar dhe përfshirë EZHQ-në, në sistemet e tyre edukative formale, në të gjitha lëndët e lidhura me të dhe në edukimin joformal dhe informal. Kjo do të pajisë njerëzit me njohuri dhe aftësi për zhvillimin e qëndrueshëm duke i bërë ata më kompetentë dhe me besim si dhe duke rritur mundësitë e tyre për të luftuar për një jetë më të shëndetshme dhe më të begatë, në harmoni me natyrën³ dhe duke ruajtur vlerat sociale, barazinë gjinore dhe shumëllojshmërinë kulturore.

7. Objektivat e Strategjisë, që do të kontribuojnë në arritjen e qëllimit, janë:

- (a) të sigurojë që politika, kuadri ligjor operacional dhe rregullator mbështesin EZHQ;
- (b) të nxisë zhvillimin e qëndrueshëm nëpërmjet të mësuarit joformal dhe informal;
- (c) t'u japë mësuesve kompetencën për të përfshirë, në planin e tyre mësimor, Zhvillimin e Qëndrueshëm;
- (d) të sigurojë materialet dhe mjetet e përshtatshme për zhvillimin e qëndrueshëm;
- (e) të nxisë studimet për zhvillimin e EZHQ;
- (f) të forcojë bashkëpunimin për EZHQ, në të gjitha nivelet brenda rajonit të UNECE.

II. QËLLIMI

8. Strategjia do të pranohet nga vendet anëtare të UNECE. Shtetet jashtë këtij rajoni janë gjithashtu të mirëpritura për ta ndjekur atë.

9. Strategjia i drejtohet qeverive, duke i nxitur dhe këshilluar ato si të zhvillojnë politika dhe praktika, që përfshijnë zhvillimin e qëndrueshëm në sistemin edukativ dhe procesin e të mësuarit, nëpërmjet përfshirjes së mësuesve dhe aktorëve të tjerë. Meqenëse edukimi për zhvillimin e qëndrueshëm duhet të marrë parasysh faktorët lokalë, qarqeve, kombëtarë dhe rajonalë, ai mund të vërë theksin në drejtime të ndryshme të zhvillimit të qëndrueshëm, në varësi të vendit dhe fushës së edukimit. Kjo Strategji do të shërbejë si një kuadër ligjor fleksibël për vendet e rajonit, duke

³ Deklarata e Rios për Mjedisin dhe Zhvillimin konstaton se njeriu është në qendër të çështjeve për zhvillimin e qëndrueshëm, dhe se ai ka të drejtën për një jetë të shëndetshme dhe të begatë, në harmoni me natyrën. (Shiko gjithashtu "Plani i Zbatimit", Samiti Botëror për Zhvillimin e Qëndrueshëm, Kombet e Bashkuara, 2002)

ditur që zbatimi i tij varet prej përparësive dhe nismat e ketyre vendeve sipas nevojave dhe kushteve të veçanta.

10. Strategjia përkrah bashkëpunimin dhe përfshirjen ndërdikasteriale⁴ e shumëaktorëshe, duke investuar në burimet njerëzore dhe materiale në Edukimin për Zhvillimin e Qëndrueshëm.

11. Strategjia përfshin kushtet kryesore të Edukimit për të Gjithë: Përbushjen e Angazhimeve⁵ Tona të Përbashkëta

12. Strategjia përkrah zbatimin e komunikimit, edukimit, pjesëmarrjes publike dhe rritjes së njohurive për marrëveshjet mjedisore shumëpalëshe dhe marrëveshjeve të tjera që kanë lidhje me këtë strategji. Ajo mbështet, gjithashtu, zbatimin e parimit të 10^{të} Deklaratës së Rios për Mjedisin dhe Zhvillimin, Konventën e Aarhusit⁶, Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara⁷ dhe Edukimin Cilësor⁸ duke përkrahur vendimmarrje transparente, gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme, si dhe fuqizimin e njerëzve.

III. PARIMET

13. Është e nevojshme të mbahet parasysh evoluimi i kuptimit për zhvillimin e qëndrueshëm. Prandaj zhvillimi i një shoqërie të qëndrueshme duhet parë si proces i vazhdueshëm i të mësuarit, duke zgjidhur çështje dhe dilema, ku përgjigjet dhe zgjidhjet mund të ndryshojnë me geumbullimin e vazhdueshëm të përvojës. Objektivat për të mësuarin rreth EZHQ duhet të përfshijnë njohuri, aftësi, qëndrime dhe vlera.

14. EZHQ është ende në zhvillim si një koncept i gjerë dhe gjithëpërfshirës, duke përfshirë në vetvete çështje sociale, ekonomike dhe ato të lidhura me mjedisin. Ai ka zgjeruar konceptin e edukimit mjedisor (EM), duke trajtuar një gamë gjithnjë e më të gjerë të çështjeve që lidhen me zhvillimin. EZHQ, gjithashtu, përfshin shumë elementë të zhvillimit dhe forma të tjera të edukimit. Si pasojë, edukimi mjedisor duhet të zhvillohet dhe plotësohet me fusha të tjera të edukimit, me një frymë integrimi drejt edukimit për zhvillimin e qëndrueshëm.

15. Ndërmjet të tjerash, çështjet kryesore të zhvillimit të qëndrueshëm përfshijnë zbutjen e varfërisë, qytetarinë, paqen, etikën, përgjegjësinë në nivel lokal dhe botëror, demokracinë dhe qeverisjen, drejtësinë, sigurinë, të drejtat e njeriut, shëndetin, barazinë gjinore, larminë kulturore, zhvillimin rural dhe urban, ekonominë, çështjet e prodhimit dhe konsumit, përgjegjësinë e përbashkët, mbrojtjen e mjedisit, manaxhimin e burimeve natyrore dhe shumëllojshmërinë e peizazheve dhe atë biologjike⁹. Trajtimi i temave kaq të ndryshme në EZHQ kërkon një trajtim holistik¹⁰.

16. Për zbatimin e Edukimit për Zhvillimin e Qëndrueshëm duhen adresuar fushat e mëposhtëme: përmirësimi i edukimit bazë, riorientimi i edukimit drejt zhvillimit të qëndrueshëm, rritja e informacionit për publikun dhe nxitja e trajnimeve¹¹

⁴ Midis organeve shtetërore.

⁵ Kuadri për Veprim i Dakarit, Organizata për Kulturën, Shkencën dhe Arsimin e Kombeve të Bashkuara UNESCO, 2000.

⁶ Konventa e UNECE për të drejtën për informacion, pjesëmarrje publike në vendimmarrje dhe të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet mjedisore, Aarhus (Danimarkë), 1998

⁷ Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Mijëvjeçarin, Asambleja e Përgjithshme, Mbledhja e 8të plenare, 2000

⁸ Komunikata e Përbashkët e Ministrave të Arsimit pjesëmarrës në Konferencën 32^{-të} e Përgjithshme të Organizatës për Kulturën, Shkencën dhe Arsimin të Kombeve të Bashkuara (UNESCO), 2003

⁹ Shiko gjithashtu Kuadrin për Zbatimin e skemës për Dhjetëvjeçarin e Edukimit për Zhvillimin e Qëndrueshëm, Organizata Kulturore Shkencore dhe Arsimore e e Kombeve të Bashkuara (UNESCO), 2003.

¹⁰ Shiko gjithashtu Deklaratën për Edukimin për Zhvillimin e Qëndrueshëm.

¹¹ Shiko gjithashtu Axhendën 21.

17. EZHQ - ja duhet të ushqejë respektin dhe mirëkuptimin për kulturat e ndryshme dhe të japë kontribut për to. Kontributi i popullsisë vendase është i domosdoshëm dhe ata duhet të jenë pjesë e partneritetit në procesin e zhvillimit të programeve të edukimit. Njohja e traditës duhet të vlerësohet dhe ruhet si një pjesë përbërëse e EZHQ.

18. Nxënësit e të gjithë niveleve duhen nxitur për të menduar dhe reflektuar sistematikisht, në mënyrë kritike dhe krijuese si për çështjet lokale dhe ato globale; të cilat përbëjnë dhe kushtet paraprake për të vepruar për zhvillimin e qëndrueshëm¹².

19. EZHQ është një proces që zgjat gjithë jetën, që fillon nga fëmijëria e hershme deri në edukimin e brezave të rritur dhe shkon më tej se edukimi formal. Vlerat, të tilla si mënyra e jetesës dhe qëndrimet fitohen që në fëmijëri, prandaj roli i edukimit është i një rëndësie të veçantë për fëmijët. Meqenëse të mësuarit varet prej funksioneve të ndryshme që kryejmë gjatë jetës sonë, EZHQ duhet të konsiderohet si një proces që zgjat gjithë jetën. Ai duhet të përshkojë programet mësimore në të gjitha nivelet, duke përfshirë edukimin profesional, trajnimin për mësuesit dhe edukimin e vazhdueshëm për profesionistët dhe vendimmarrësit.

20. Edukimi i mëtejshëm kontribon në EZHQ për zhvillimin e njohurive dhe kompetencave përkatëse.

21. EZHQ duhet të marrë parasysh faktorët e ndryshëm lokalë, kombëtarë dhe rajonalë sikundërse edhe çështjen globale, për të gjetur balancën midis interesave lokalë dhe atyre globalë.

22. EZHQ duhet të kontribuojë në zhvillimin e zonave urbane dhe rurale duke mundësuar edukimin dhe përmirësuar cilësinë e tij. Kjo do të ndihmonte veçanërisht banorët e zonave rurale.

23. Trajtimi i çështjeve etike, duke përfshirë çështjet e barazisë, solidaritetit dhe varësinë e ndërsjelltë në brezat të tanishëm dhe ndërmjet brezave, marrëdhëniet midis njerëzve dhe natyrës, midis të pasurve dhe të varfërve, është në qendër të zhvillimit të qëndrueshëm dhe, për pasojë është jetik për EZHQ. Përgjegjësia është pjesë e trashëguar e etikës dhe përbën një çështje praktike për EZHQ.

24. Edukimi formal për zhvillimin e qëndrueshëm duhet të bëhet pjesë e jetës dhe e punës e duhet të shkojë përtej mësimdhënies. Mësuesit¹³ e përfshirë në EZHQ luajnë një rol të rëndësishëm në lehtësimin e këtij procesi dhe në nxitjen e debatit ndërmjet nxënësve e studentëve dhe autoriteteve e shoqërisë civile¹⁴. Në këtë mënyrë, EZHQ paraqet një mundësi që edukimi të kapërcejë izolimin dhe barrierat shoqërore.

25. EZHQ përfshin nismat për zhvillimin e kulturës së respektit të ndërsjelltë në komunikim dhe vendimmarrje, duke u larguar prej dhënies së informacionit të thjeshtë, drejt të mësuarit pjesëmarrës¹⁵. Si rrjedhim, EZHQ duhet të kontribuojë në politikat interaktive dhe integruese si dhe në vendimmarrje. Duhet të merret, gjithashtu, në konsideratë roli i EZHQ në zhvillimin dhe rritjen e pjesëmarrjes

¹² Shiko gjithashtu Deklaratën për Edukimin për Zhvillimin e Qëndrueshëm.

¹³ Edukatorët janë mësuesit, pedagogët, trajnuesit dhe të gjithë specialistët e tjerë që lidhen me çështjet e edukimit, si dhe drejtuesit vullnetarë të edukimit.

¹⁴ Shiko gjithashtu Deklaratën për Edukimin për Zhvillimin e Qëndrueshëm.

¹⁵ Deklarata e Selanikut, Selanik, Greqi, 1997. Disa vende përdorin termin: "të mësuarit social", për të mësuarit pjesëmarrës.

demokratike¹⁶ duke u përfshirë në Axfendat Lokale²¹, si një kontribut i vecantë për zgjidhjen e konflikteve në shoqëri dhe vendosjen e drejtësisë.

26. EZHQ kërkon bashkëpunimin dhe bashkëpjesëmarrjen e shumë aktorëve. Aktorët kryesorë janë qeveritë dhe autoritetet vendore, sektorët e kërkimit shkencor dhe të edukimit, sektori i shëndetit, sektori privat, industria, transporti dhe bujqësia, tregëtia dhe fuqia punëtore, sindikatat, shtypi, organizatat jofitimprurëse, komunitetet e ndryshme, popullsia vendase dhe organizatat ndërkombëtare

27. EZHQ duhet të ndihmojë në përgatitjen e marrëveshjeve mjedisore të shumëanshme dhe marrëveshjeve ndërkombëtare përkatëse të lidhura me ZHQ.

IV. NDIKIMET MBI EDUKIMIN

28. EZHQ kërkon një riorientim të ri, jo vetëm në dhënien e njohurive për problemet dhe identifikimin e zgjidhjeve të mundshme. Si pasojë, edukimi duhet të ruajë fokusin e tij tradicional në çështjet të veçanta dhe, në të njëjtën kohë, të lejojë trajtimin e përvojave jetësore ndër dhe shumëdisiplinore. Kjo mund të ketë ndikim në strukturën e programeve dhe metodave të mësimdhënies, duke kërkuar që mësuesit të ndryshojnë nga mënyra e të qenit vetëm mësimdhënës dhe nxënësit të ndryshojnë nga mënyra e të qenit vetëm mësimnxënës. Në vend të kësaj, të dy grupet duhet të formojnë një skuadër të vetme.

29. Institucionet e edukimit formal luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kapaciteteve që në moshë të vogël, duke dhënë njohuri dhe duke ndikuar në mënyrën e qëndrimit dhe sjelljen. Është e rëndësishme që të gjithë nxënësit dhe studentët të marrin njohuritë e duhura për ZHQ dhe të jenë të informuar për ndikimin që kanë vendimmarrjet që nuk mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm. Çdo institucion edukativ si i tërë, duke përfshirë nxënësit dhe studentët, mësuesit, manaxherët dhe pjesën tjetër të personelit si dhe prindërit, duhet të ndjekë parimet e ZHQ.

30. Është e rëndësishme të mbështeten aktivitetet e edukimit joformal dhe informal për zhvillimin e qëndrueshëm, meqë ato janë elemente plotësuese për edukimin formal, jo më pak të rëndësishme edhe për të mësuarin tek të rriturit. Edukimi joformal për zhvillimin e qëndrueshëm luan një rol të veçantë, sepse është shpesh i orientuar te nxënësit, pjesëmarrja dhe përkrahja e të mësuarit gjatë gjithë jetës. Të mësuarit informal në vendin e punës, rrit aftësitë e të dy palëve, si të punëdhënësve dhe punonjësve. Si rrjedhim, duhet njohur dhe nxitur bashkëpunimi midis aktorëve të ndryshëm të përfshirë në të gjitha format e EZHQ.

31. Një trajnim fillestar i përshtatshëm, ritrajnimi i mësuesve dhe krijimi i mundësive për të ndarë përvojat e tyre, janë veprime shumë të rëndësishme për suksesin e EZHQ. Me rritjen e ndërgjegjësimit dhe njohurive në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm dhe, në veçanti, me veçoritë e ZHQ në fushat ku punojnë, mësuesit mund të jenë më efektivë dhe të drejtojnë përmes dhënies së shembujve. Si rrjedhim, trajnimi duhet lidhur ngushtësisht me përfundimet e kërkimeve të kryera për ZHQ.

32. Mësimdhënia dhe mësimnxënia në EZHQ janë përmirësuar shumë përse i përket kapacitetit, cilësisë dhe mjeteve të mësimdhënies. Gjithsesi, këto mjete nuk janë të mundshme në të gjitha vendet. Ky është një problem për të gjithë sektorin e edukimit

¹⁶ Axfenda 21

formal, atë informal dhe joformal. Si rrjedhim, duhen bërë përpjekje të mëdha për zhvillimin dhe prodhimin e tyre. Duhet nxitur lidhja logjike midis mjeteve të mësimdhënies në edukimin formal dhe atë joformal, ndaj sfida qëndron te fakti se sa janë të përshtatshme për ZHQ dhe të përballeshme në nivelin lokal.

33. Që EZHQ të jetë efektive duhet që:

(a) Të jetë e drejtuar në dy mënyra: (i) nëpërmjet futjes së tematikave të EZHQ në të gjitha lëndët, programet dhe kurset, dhe (ii) nëpërmjet përgatitjes së tematikave specifike, të programeve dhe kurseve;

(b) të fokusohet në dhënien e përvojave të vlefshme për të patur sjellje të qëndrueshme, duke përfshirë këtu në institucionet edukative, në vendin e punës, në familje dhe komunitet;

(c) të rrisë bashkëpunimin dhe partneritetin midis anëtarëve të institucioneve edukuese dhe aktorëve të tjerë. Përfshirja e mëtejshme e sektorit privat dhe industrisë në proceset edukative, do të ndihmojë të trajtojë si duhet ndryshimet e shpejta teknologjike dhe ndryshimin e kushteve të punës. Aktivitetet mësimdhënëse në lidhje të ngushtë me shoqërinë, do të rritin përvojat praktike të nxënësve;

(d) të mund të depërtojë në problemet globale, rajonale, kombëtare dhe lokale mjedisore, duke i shpjeguar ato nëpërmjet konceptit të ciklit jetësor dhe duke u fokusuar jo vetëm në ndikimin mjedisor, por edhe në problemet ekonomike dhe sociale, duke trajtuar mjedisin natyror dhe atë të modifikuar nga njeriu.

(e) të përdorë një gamë të gjerë metodash edukimi pjesëmarrës, i drejtuar nga proceset dhe gjetja e zgjidhjeve, të përgatitura posaçërisht për nxënësit. Në ndryshim nga metodat tradicionale, këto duhet të përfshijnë përveç të tjerash diskutime, planifikimin e koncepteve dhe perceptimit, pyetje filozofike, vlerësim aftësish, stimulime, plan veprime, modelime, rregullat e lojës, lojëra, teknologji informimi dhe komunikimi, vëzhgime, raste studimore, ekskursione dhe mësimin në natyrë, projekte të drejtuara për nxënësit, analiza të praktikave të mira, përvojë pune, dhe zgjidhje problemesh.

(f) të mbështetet nga mjetet dhe udhëzuesit e duhur, siç janë publikime metodike, pedagogjike dhe didaktike, libra shkollorë, mjete vizuale, broshura, raste studimore dhe praktika të dobishme, burime elektronike audio dhe video.

34. Qeveritë duhet të mbështesin edukimin formal dhe joformal, sepse qytetarët e informuar dhe konsumatorët e mirëinformuar, nëpërmjet veprimeve dhe zgjedhjeve të tyre, janë vepruesit kryesorë për zbatimin e masave të qëndrueshme, duke përfshirë këtu edhe Axhendën 21.

35. Edukimi formal dhe joformal, duke përfshirë dhe programet e ndërgjegjësimit të publikut, duhet të synojë të sigurojë një kuptim më të mirë të lidhjeve ndërmjet çështjeve mjedisore, ekonomike dhe sociale, në nivelin lokal dhe global dhe në perspektivën e së ardhmes. Komunitetet, familjet, shtypi dhe OJFtë janë aktorë të rëndësishëm për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për ZHQ.

36. OJFtë janë burim i rëndësishëm për edukimin informal dhe joformal, të afta të zbatojnë procese të fuqizimit të shoqërisë civile, duke futur dhe shndërruar njohuritë shkencore dhe faktet në formën e një informacion të kapshëm për të gjithë. Roli i tyre si ndërmjetës midis qeverisë dhe publikut duhet njohur, përkrahur dhe mbështetur. Partneriteti midis OJFve, qeverive dhe sektorit privat është vlerë e shtuar për EZHQ.

37. Shtypi është një forcë e madhe në drejtimin e zgjedhjes që bën konsumatori dhe në mënyrën e jetesës, veçanërisht te fëmijët dhe të rinjtë. Sfida qëndron në përdorimin e njohurive dhe kanalizimin e duhur të informacionit të besueshëm dhe mesazheve kyçe për çështjet e lidhura me ZHQ.

38. Të gjithë sektorët e prodhimit duhet të kontribuojnë në qëndrueshmërinë kombëtare, rajonale dhe globale. Zhvillimi i programeve të specializuara të trajnimit për t'iu dhënë profesionistëve dhe vendimmarrësve njohuritë dhe aftësitë për të kontribuar në ZHQ është përcaktuar si një element vendimtar i edukimit për zhvillimin e qëndrueshëm¹⁷.

39. Për këtë qëllim, edukimi profesional dhe ai gjatë gjithë jetës luajnë një rol të rëndësishëm dhe duhet ofruar për vendimmarrësit dhe profesionistët, veçanërisht për ata që marrin pjesë në planifikim dhe manaxhim. Ai duhet përqendruar tek shtimi i njohurive dhe ndërgjegjësimi për ZHQ. Edukimi i vazhdueshëm ka dy drejtime kryesore për veprim:

(a) rritjen e njohurive dhe të aftësive dhe;

(b) dhënien e kompetencave të nevojshme në profesione të tjera dhe në situata të ndryshme. Edukimi i vazhdueshëm është një nga fushat që mund të përfitojë nga bashkëpunimi ndërmjet sektorëve të edukimit, aktorëve dhe komunitetit në tërësi.

40. Programet trajnuese duhet të trajtojnë temat kryesore të ZHQ, por në të njëjtën kohë të marrin parasysh nevojat e profesioneve të ndryshme dhe lidhjen e këtyre temave me fushat e punës në të cilat ata veprojnë. Një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet temave të lidhura me përgjegjësinë kryesore të një profesioni dhe ndikimet mjedisore, sociale dhe ekonomike të tij.

41. Që EZHQ të bëhet pjesë e programit për ndryshim, drejt një shoqërie më të qëndrueshme, edukimi, në vetvete, duhet të jetë objekt ndryshimi. Duhet nxitur kërkimi që kontribuon në EZHQ. Është e nevojshme rritja e bashkëpunimit dhe partneritetit ndërmjet aktorëve të përfshirë në kërkim dhe zbatim, duke filluar prej përcaktimit të problemeve dhe deri tek përfshirja dhe përhapja e njohurive të reja. Rezultatet e kërkimit dhe përpjekjet për zhvillim duhen ndarë midis aktorëve në nivel lokal, rajonal dhe global, dhe duhen futur në pjesë të ndryshme të sistemit edukativ, përvojës dhe praktikës.

V. KUADRI PËR ZBATIM

1. Zbatimi kombëtar/shtetëror

42. Çdo vend është përgjegjës për zbatimin e kësaj strategjie. Për përfshirjen e perspektivave të ZHQ në edukim, është e nevojshme një mbështetje dhe vullnet i fuqishëm politik, në të gjitha nivelet qeverisëse. Për këtë qëllim, rekomandohet që vendet të përkthejnë strategjinë në gjuhën (gjuhët) e tyre zyrtare, dhe ku është e nevojshme, në gjuhën(t) e minoriteteve, ta shpërndajnë në autoritetet përkatëse dhe të përcaktojnë një pikë fokale.

¹⁷ Shiko gjithashtu Kuadrin për Zbatimin e skemës për Dhjetëvjeçarin e Edukimit për Zhvillimin e Qëndrueshëm.

43. Zbatimi efektiv i Strategjisë kërkon që kërkesat e saj të përfshihen në strategjitë të planifikimit, investimit dhe manaxhimit të çdo shteti dhe të qeverive vendore për të gjitha nivelet e edukimit, institucionet dhe organizatat e edukimit. Në të njëjtën kohë, zbatimi duhet të jetë në përputhje me nismat e shteteve të tjera, dypalëshe dhe shumëanshme. Instrumentet ekonomike dhe të komunikimit duhen përshtatur sipas kushteve të çdo vendi. Në këtë mënyrë, vendet duhet të zbatojnë kërkesat e strategjisë në përputhje me legjislacionin, politikat dhe kuadrin e veprimeve të tyre.

44. Vendet duhet të përcaktojnë detyrimet e tyre për komunikimin, edukimin, pjesëmarrjen dhe ndërgjegjësimin e publikut, të rrjedhura prej marrëveshjeve mjedisore ndërkombëtare dhe marrëveshjeve të tjera që kanë lidhje me këtë çështje për t'i trajtuar ato në mënyrë sa më të përshtatshme në EZHQ.

45. Sektori i edukimit përbëhet nga një numër i madh aktorësh, që në vende të ndryshme kanë sisteme të ndryshme rregulluese dhe manaxhimi. Gjithashtu përfshin njerëz që i takojnë moshave dhe pozitive të ndryshme shoqërore të ndryshme. Sfidat qëndron te drejtimi dhe zbatimi i reformës së nevojshme në politikat vendimmarrëse dhe kuadrin operacional të sektorit të edukimit mbi bazën e besimit, gjithëpërfshirjes, mbështetjes dhe përkrahjes së vetëvlerësimit. Është e rëndësishme që në zbatimin e Strategjisë, këta sektorë përgjegjës për edukimin formal, joformal dhe informal të bashkëpunojnë me autoritetet përkatëse shtetërore.

46. Bashkëpunimi, ndarja e përgjegjësisë dhe drejtimi i të gjitha organeve shtetërore, duhen konsideruar si një mekanizëm i rëndësishëm i qeverisjes së mirë që duhet fuqizuar. Ministrinë e Arsimit dhe të Mjedisit, në veçanti, duhet të bashkëpunojnë dhe të jenë nismëtare për fillimin dhe përkrahjen e integritit të mëtejshëm të çështjeve të ZHQ në politikat e edukimit formal, programet dhe kurrikulat e të gjitha niveleve dhe të vlerësojnë ecurinë në zbatimin e strategjisë. Gjithsesi, kërkohet një bashkëpunim i ngushtë dhe efektiv me autoritete të tjera publike dhe me aktorët e tjerë vendorë, në veçanti me autoritetet përgjegjëse për çështjet e ekonomisë.

47. Është e nevojshme ngritja e një mekanizmi koordinimi për zbatimin e Strategjisë në nivel shtetëror, si dhe për shpërndarjen e informacionit dhe nxitjen e partneritetit midis aktorëve¹⁸ të ndryshëm. Një mundësi është ngritja e “një platforme kombëtare për EZHQ”, mundësisht nën Këshillat për Zhvillimin e Qëndrueshëm, apo të institucioneve të tjera të lidhura me këtë çështje, duke bashkuar profesionistë nga sektorë të ndryshëm.

48. Planet kombëtare të zbatimit¹⁹ duhet të shërbejnë si një element i rëndësishëm për zbatim. Vendet duhet të vendosin për institucionin përgjegjës për hartimin e planit kombëtar të zbatimit.

49. Plani kombëtar i zbatimit duhet përgatitur me metodën pjesëmarrëse. Si rrjedhim duhet të përfshihen të gjithë aktorët. Duhet të merret parasysh gjendja e vendit. Duke pranuar faktin se, në përputhje me nevojat që kanë, vendet mund të paraqesin përparësitë e tyre dhe programet për zbatim, programet, politikat dhe kërkesat e këtij kapitulli mund të shërbejnë si udhëzues për këtë çështje. Planet kombëtare të zbatimit

¹⁸ Disa vende kanë futur konceptin “manaxhim i njohurive”.

¹⁹ Për vendet me një strukturë federale qeverisje, të gjitha referencat për planet kombëtare t'i takojnë planeve kombëtare dhe rajonale kur është e nevojshme.

duhet të përmbajnë objektiva, aktivitete, masa, afate kohore për zbatimin, mjetet e nevojshme dhe mënyrën e vlerësimit.

2. Fushat e veprimit

Garancia që kuadri rregullator, i politikave dhe ai operativ përkrah nxitjen e EZHQ

50. Kuadri i politikave, kuadri ligjor dhe operativ dhe kurrikula duhet të përfshijnë dhe të mbështesin EZHQ. Masat kyçe për të arritur këtë synim mund të jenë: Përgatitja e plan veprimeve për EZHQ në të gjitha nivelet e edukimit; nxitja e zhvillimit të bashkëpunimit midis departamenteve dhe subjekteve të ndryshme, duke përfshirë këtu ngritjen e mekanizmave konsultues; futjen e parimeve të ZHQ në programet mësimore dhe kurset e veçanta për të gjitha nivelet e edukimit më të përparuar, veçanërisht në trajnimet paraprake të mësuesve; përmirësimin e masave dhe manaxhimit të edukimit drejt ZHQ dhe forcimi i lidhjes midis shkencave natyrore, ekonomike, politike dhe sociale përmes studimeve ndërdisiplinore, shumëdisiplinore dhe të specializuara. Studimet ndërdisiplinore dhe ato të specializuara duhet të jenë të ekuilibruara ndërmjet tyre.

Nxitja e ZHQ përmes të mësuarit formal, joformal dhe informal.

51. Duhet nxitur ndërgjegjësimi i publikut lidhur me ZHQ, në/dhe përmes institucioneve të edukimit, si dhe komuniteteve, familjeve, mediave dhe OJFve.

52. Duhet përmirësuar vazhdimisht aftësitë profesionale dhe njohuritë për zhvillimin e qëndrueshëm për të qenë pjesë e të mësuarit gjatë gjithë jetës, duke përfshirë edhe sektorë të tillë si administrata publike, sektori privat, industria, transporti dhe bujqësia. Për sa kohe që shumë fusha të ekspertizës janë në zhvillim e sipër, marrja e dijeve të reja dhe nevoja për të përfshirë aftësi të reja, në mënyrë që të plotësojnë përmbajtjen specifike në konceptet e ZHQ, do të mbeten gjithnjë nevojë e vazhdueshme.

53. Masat kyçe për të arritur këtë synim mund të jenë: dhënia e mundësisë për të mësuar më shumë rreth ZHQ në edukimin e vazhdueshëm të specialistëve, duke i përfshirë në planifikim, manaxhim dhe masmedia; nxitja dhe mbështetja e aktiviteteve në komunitet rreth ndërgjegjësimit të publikut për ZHQ; nxitja e bashkëpunimit me OJFtë dhe mbështetja e aktivitetit të tyre; nxitja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të edukimit formal e organizatave të edukimit joformal si dhe aktiviteteve joformale, nxitja e medias për të informuar e debatuar çështje rreth ZHQ, në mënyrë që të arrijnë deri tek publiku i gjerë.

Zhvillimi i kompetencës në sektorin edukativ të përfshirë në EZHQ

54. Për të patur një drejtim dhe mbështetje sa më të mirë, edukatorët, drejtuesit dhe vendimmarrësit e të gjitha niveleve të edukimit duhet të shtojnë njohuritë e tyre për edukimin për zhvillimin e qëndrueshëm. Pavarësisht nga kjo gjë, është e nevojshme të shtohen përpjekjet për të rritur aftësitë drejtuese në të gjitha nivelet e edukimit formal dhe joformal.

55. Masat kyçe për të arritur këtë synim janë: nxitja e zhvillimit të kompetencës së personelit në sistemin edukativ, duke përfshirë dhe masat për drejtuesit për rritjen e ndërgjegjësimit të tyre ndaj ZHQ; zhvillimi i kriterëve për të vlerësuar nivelin e kompetencës profesionale në EZHQ, zhvillimi dhe përfshirja e sistemeve të manaxhimit në EZHQ në institucionet e edukimit formal dhe strukturat e edukimit joformal; përfshirja e çështjeve të lidhura me ZHQ në programet e trajnimit dhe të ritrajnimit të mësuesve në të gjitha nivelet e edukimit; dhe nxitja e shkëmbimit të përvojave ndërmjet mësuesve në edukimin formal dhe joformal.

Sigurimi i mjeteve dhe materialeve të duhura për EZHQ

56. Është e nevojshme të përgatiten materiale për EZHQ në të gjitha nivelet, për edukimin e përgjithshëm, atë teknik dhe për të mësuarin autodidakt në përshtatje me kushtet dhe nevojat lokale.

57. Masat kyçe për të arritur synim këtë mund të jenë: nxitja e zhvillimit dhe prodhimit të materialeve në gjuhën e çdo vendi për edukatorët, nxënësit dhe kërkuesit në të gjitha nivelet e edukimit dhe trajnimit; nxitja e zhvillimit dhe përdorimit të mjeteve elektronike, audio, video dhe multimedia si dhe mjeteve vizive për qëllime të mësimdhënies dhe shkëmbimit të informacionit; krijimi i lehtësirave në përdorimin e burimeve të informacionit rreth EZHQ përmes mjeteve elektronike dhe internetit; përputhja e materialeve për të mësuarin formal, joformal dhe informal, zhvillimi i strategjive përkatëse për shpërndarjen e tyre.

Nxitja e kërkimit shkencor për zhvillimin e EZHQ.

58. Janë të nevojshme kërkimet dhe aktivitetet zhvilluese në fusha të ndryshme të EZHQ, të tilla si metodat efektive të të mësuarit, mjetet vlerësuese, formimi i vlerave dhe qëndrimeve, zhvillimi institucional/shkollor dhe zbatimi i Teknologjive të Informimit dhe Komunikimit. Kërkimi dhe studimi për EZHQ duhet të përbëjë një bazë të vazhdueshme për zhvillimin e EZHQ.

59. Rezultatet e kërkimeve dhe përpjekjet për zhvillim, duhen ndarë me aktorët që veprojnë lokalisht, në rajon dhe globalisht, dhe duhen integruar në pjesët e ndryshme të sistemit edukues.

60. Masat kyçe që duhen marrë për të arritur këtë synim mund të jenë: fillimi, nxitja dhe zhvillimi i kërkimeve në: përmbajtjen e EZHQ dhe metodat e mësimdhënies dhe të mësimnxënies; efektet dhe instrumentat ekonomike të EZHQ; mënyrat e përfshirjes së aspekteve të ZHQ dhe kontekstit të tyre lokal në çështje të ndryshme, duke i dhënë përparësi kërkimeve që trajtojnë së bashku dimensionet e ndryshme të ZHQ; treguesit dhe vlerësimi i instrumentave për EZHQ; si dhe shkëmbimi i rezultateve të kërkimeve dhe shembujve të praktikave të mira.

3. Bashkëpunimi ndërkombëtar

61. Përkrah kontributit për forcimin dhe përmirësimin e EZHQ në vende të ndryshme, bashkëpunimi në edukimin për zhvillimin e qëndrueshëm mund të ndihmojë në arritjen e mirëkuptimit reciprok, forcimin e besimit dhe zhvillimin e respektit për

vlerat kulturore dhe si pasojë ndërtimin e lidhjeve miqësore midis njerëzve dhe kombeve, pra do të kontribuojë për mirëqënien dhe paqen.

62. Në nivel rajonal është e nevojshme të rishikohet dhe lehtësohet zbatimi i Strategjisë dhe të mbështetet bashkëpunimi për EZHQ. Proceset rajonale duhet të mbajnë parasysh edhe zhvillime të tjera që ndodhin në kuadër të Dhjetëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara për Edukimin për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe të shihen si kontribut në për nismat globale të EZHQ.

63. Rajoni ka përvojë të mirë në bashkëpunimin ndërkombëtar, veçanërisht në edukimin e avancuar. Shumë rrjete kombëtare dhe nënrajonale, edukimi, grupe pune, rrjete dhe shoqata universitare, programe dhe partneritete po punojnë për zhvillimin e formave shumëdisiplinore të edukimit për t'u gjetur zgjidhjen problemeve të zhvillimit të qëndrueshëm. Sfida qëndron në faktin se si mund të përdoret në mënyrë më efikase përvoja dhe potenciali i tyre për të nxitur EZHQ. Një sfidë tjetër është edhe ajo e kërkimeve për çështje të tjera të lidhura me EZHQ, të cilat ende nuk kanë një rol të dukshëm në arenën ndërkombëtare. Gjithashtu, është i nevojshëm bashkëpunimi ndërkombëtar për EZHQ në fushat e edukimit parashkollor dhe atë shkollor.

64. Përparësi iu duhet dhënë forumeve rajonale dhe nënrajonale, që mbledhin së bashku anëtarë të komunitetit të fushës së edukimit të tillë si nëpunës civilë, edukatorë e kërkues, si dhe aktorë të tjerë që shkëmbejnë mes tyre përvojën dhe praktikën e mira në lidhje me ZHQ dhe EZHQ.

65. Natyra e ndërlikuar e EZHQ kërkon që, përkrah komunitetit të edukimit, për zbatimin e EZHQ, të ftohen për të punuar në partneritet dhe aktorë të tjerë ndërkombëtarë. Kjo është veçanërisht e dobishme, për bashkëpunimin ndërkombëtar që synon përmirësimin e njohurive dhe aftësive për ZHQ të profesionistëve të ndryshëm dhe vendimmarrësve.

66. Përvojat dhe nevojat ndryshojnë në pjesë të ndryshme të rajonit të UNECE. Bashkëpunimi midis nënrajoneve duhet forcuar më tej. Kjo do të bëjë të mundur që të punohet më shumë për çështjet më të rëndësishme të çdo nënrajoni të dhënë, dhe, si rezultat, të ndihmohen më mirë vendet për të arritur rezultatet praktike më të mira.

67. Është e nevojshme të bëhen vlerësime të mëtejshme të nevojave të nënrajoneve të ndryshme. Rëndësi e veçantë i duhet kushtuar vendeve të Evropës Lindore, rajonit të Kaukazit, Azisë Qendrore dhe Evropës Juglindore në zgjidhjen e problemeve të tyre kryesore lidhur me edukimin mjedisor dhe zhvillimin e qëndrueshëm.²⁰ Disa nga problemet e tyre vijnë si pasojë e mungesës së mjeteve të nevojshme udhëzuese, përdorimi jo i efektshëm i kapaciteteve të arsimit të lartë dhe institucioneve kërkimore, mungesa e edukatorëve me nivel të lartë dhe ndërgjegjësimi i pamjaftueshëm si pasojë e mungesës së bashkëpunimit midis departamenteve dhe subjekteve që punojnë për EZHQ. Një sfidë tjetër që i adresohet Evropës Qendrore dhe rajonit të Kaukazit, Azisë Qendrore dhe Evropës Juglindore është cilësia e ulët e edukimit të fëmijëve që banojnë në zonat rurale si dhe mungesa e burimeve financiare dhe njerëzore për zhvillimin e EZHQ në këto zona. Prandaj, ndërtimi i kapaciteteve, ndihma financiare dhe mbështetja për edukimin, kërkimet dhe programet

²⁰ Shihni gjithashtu Partneritetet mjedisorë në rajonin e UNECE: Strategjia mjedisorë për vendet e Evropës Lindore, Kaukazin dhe Azinë Qendrore. Planin Strategjik; Konferenca e Pestë Ministrore "Mjedisi për Evropën", Kiev 2003

ndërgjegjësuere për ZHQ në vendet me tranzicion ekonomik duhet të pranohen si çështje të rëndësishme dhe të merren në konsideratë përkatësisht nga qeveritë, organizatat përkatëse dhe donatorët²¹.

68. Masat kyçe mund të jenë në forcimin e aleancave dhe lidhjeve rajonale dhe nënrajonale për EZHQ dhe nxitjen e programeve të binjakëzimit, bashkëpunimin dypalësh dhe partneritetin; përdorimin në mënyrën e duhur të instrumentave ligjorë ekzistues ndërkombëtarë të tillë si Konventa e Aarhusit si dhe marrëveshje të tjera për të rritur ndërgjegjësimin për ZHQ; ndihmesën në shkëmbimin e përvojave dhe praktikave pozitive, risitë dhe dhënien e informacioneve rreth përvojave kombëtare dhe projekteve të bashkëpunimit për zhvillim lidhur me EZHQ, për shembull duke përdorur mjetet e teknologjisë së informimit dhe faqen e internetit të UNECE; përfshirjen e EZHQ në programet dypalëshe dhe shumëpalëshe; nxitjen e pjesëmarrjes së OJFve dhe grupeve të tjera të rëndësishme në bashkëpunimin ndërkombëtar për EZHQ; nxitjen dhe koordinimin e aktiviteteve ndërkombëtare për ndërgjegjësimin për ZHQ; si dhe nxitjen e shkëmbimit të përvojave.

69. Për të siguruar qeverisje dhe komunikim efektiv rajonal, është i nevojshëm caktimi i personave të kontaktit për EZHQ në të gjitha shtetet anëtare të UNECE dhe në organizatat ndërkombëtare përkatëse. Për të ndjekur zbatimin e Strategjisë duhet të ngrihet një komitet drejtues, i përbërë nga përfaqësues të sektorëve të edukimit dhe mjedisit (ose sektorëve të tjerë të lidhur me to). Procesi “Mjedisi për Evropën” duhet të përdoret si një platformë në bashkëpunimin rajonal për EZHQ dhe Komisioni i UNECE për Politikën Mjedisore do të jetë një institucion vlerësues i ecurisë së zbatimit të Strategjisë, në përputhje me programin e punës së Komisionit.

70. Në konferencat e tyre “Mjedisi për Evropën”, ministrat mund të shprehin interesin të diskutojnë për ecurinë e zbatimit të strategjisë, të bazuar në raportet kombëtare dhe raporte të tjera të lidhura me të. Gjithashtu, Vlerësimet e Performancës Mjedisore janë një vlerësim të përpjekjeve të vendit në drejtim të EZHQ.

4. Rolet dhe Përgjegjësitë

71. Qeveritë duhet të luajnë një rol aktiv në përkrahjen dhe lehtësimin e zbatimit të strategjisë në vendet e tyre. Ato duhet të vlerësojnë dhe ndjekin rregullisht zbatimin në të gjitha nivelet e qeverisjes.

72. Autoritetet vendore të edukimit dhe institucionet e edukimit formal duhet të marrin përgjegjësi për zbatimin e kërkesave të Strategjisë dhe monitorimit të saj.

73. Aktorët vendorë të kësaj fushe, duke përfshirë autoritetet vendore, sektorët e edukimit dhe të kërkimit shkencor, sektorin e shëndetësisë, sektorin privat, transportin dhe bujqësinë, bashkimet dhe sindikatat e punës, shtypin, organizatat jofitimprurëse, komunitetet e ndryshme, popullsinë vendase dhe organizatat ndërkombëtare duhen ftuar për të paraqitur prioritetet e tyre dhe të marrin përsipër përgjegjësi për zbatimin dhe ndjekjen e Strategjisë.

5. Çështjet financiare

²¹ Shihni gjithashtu Plani i Zbatimit; Samiti Botëror për Zhvillimin e Qëndrueshëm.

74. Sigurimi i mjeteve të nevojshme financiare për zbatimin e strategjisë është një parakusht i rëndësishëm për suksesin e saj. Për të vlerësuar me kujdes koston e veprimeve të planifikuara për zbatim, të nevojshme për të arritur objektivat e strategjisë dhe arritjen e rezultateve të pritshme të këtij investimi, është e rëndësishme të kuptohet vlera e edukimit në paraqitjen për shoqërinë, të parimeve dhe praktikave të ZHQ. Edukimi duhet parë si një investim i rëndësishëm për të ardhmen.

75. Në përgjithësi, kostoja e zbatimit të strategjisë duhet të përcaktohet nga secili vend. Si rezultat, qeveritë duhet sigurojnë burimet e nevojshme për këtë qëllim. Shumë nga planet e propozuara duhet të bëhen pjesë e punës për zhvillimin e sektorit të edukimit. Disa prej masave mund të zbatohen më lehtësisht përmes projekteve nënrajonale ose rajonale.

76. Qeveritë duhet të marrin në konsideratë buxhetin dhe instrumentat ekonomike për të financuar EZHQ në të gjitha format e edukimit, duke përfshirë futjen e dhënies së bursave dhe ngritjen e kapaciteteve në institucionet e edukimit për EZHQ. Duhet bërë përpjekje për të përfshirë komponentët e EZHQ në programet ekzistuese dypalëshe dhe shumëpalëshe. Duhet krijuar dhe nxitur partneriteti për të kërkuar mbështetje, duke përfshirë edhe kontributet materiale prej agjencive donatore ndërkombëtare dhe sektori privat. Në hapat e para të zbatimit të strategjisë, është e nevojshme dhe e rëndësishme ndihma financiare për të nisur procesin, sidomos për vendet e Kaukazit, Azisë Qendrore, Evropës Lindore dhe Evropës Juglindore.

6. Vlerësimi dhe afatet kohore

77. Për të vlerësuar zbatimin e strategjisë duhen vendosur afate kohore dhe treguesit e ecurisë. Mundësia e njerëzve për të vepruar në dobi të EZHQ ka të bëjë me nivelin e edukimit dhe rezultatet e studimit të kryera. Paraqitja dhe futja e EZHQ në të gjitha format dhe nivelet e edukimit është një proces i gjatë ku rezultatet mund të merren vetëm pas një periudhe të gjatë kohore.

78. Zbatimi i Strategjisë duhet parë si një proces i vazhdueshëm. Sidoqoftë për të vlerësuar ecurinë e zbatimit të saj propozohen tre faza:

Faza I (nga 2007): vendosja e bazave të forta për të nisur zbatimin, rekomandohet që çdo vend duhet të përcaktojë se çfarë është duke bërë dhe nëse kjo është e vlefshme për të mbështetur strategjinë. Kjo mund të përfshijë një rishikim të rregulloreve ekzistuese, strukturave operative dhe ligjore, mekanizmave financiare, aktiviteteve edukative si dhe përcaktimin e pengesave apo problemeve.

Duhet marrë në konsideratë masat korrigjuese për të kapërcyer pikat e dobëta si dhe duhet hartuar plani kombëtar i zbatimit të strategjisë. Për zbatimin e EZHQ duhet zhvilluar metodat e vlerësimit dhe treguesit e zbatimit, në veçanti ata cilësorë. Në konferencën e tyre "Mjedisi për Evropën", ministrat mund të paraqesin detyrimet e tyre ndaj strategjisë, të theksojnë sukseset, shkëmbejnë mendime dhe diskutojnë mbi çështjet në kanë lidhje me strategjinë e tyre kombëtare.

Faza II (nga 2010): zbatimi i kërkesave të strategjisë duhet bërë në mënyrën e duhur dhe duke zgjedhur rrugën e duhur. Për këtë, vendet duhet të rishikojnë ecurinë e bërë

në zbatimin e Strategjive kombëtare dhe rishikimin e tyre në rast se është e nevojshme.

Faza III (nga 2015 e tutje): Vendet duhet të kenë kryer një zbatim të ndjeshëm të kësaj strategjie.

79. Për të ndihmuar në procesin e vlerësimit të Strategjisë sipas veprimeve të kryera duhen marrë parasysh shumë çështje. Këtu përfshihen shembujt e mëposhtëm: përcaktimi i drejtuesve dhe koordinatorëve që do të drejtojnë zbatimin e strategjisë; hartimi dhe funksionimi i rregulloreve, strukturave operative dhe kuadrit ligjor që do të mbështetin strategjinë; vendosja e bashkëpunimit dhe partneritetit ndërqeveritar dhe ndërmjet shumë aktorëve të interesuar; lidhja me kurrikulën ekzistuese formale dhe programet mësimore; trajnimi fillestar dhe i vazhdueshëm rreth çështjeve që lidhen me ZHQ veçanërisht për edukatorët; materialet dhe mjetet për EZHQ; kërkime dhe zhvillim në EZHQ; zhvillimi i edukimit formal dhe joformal; përfshirjen e mediave dhe ndikimi tek nxënësit.

Shënim.

Për informacion të mëtejshëm janë të vlefshëm dy dokumenta bazë: njëri rreth proceseve ndërkombëtare të edukimit për zhvillimin e qëndrueshëm në të shkuarën dhe ata ekzistues (CEP/AC.13/2004/8/Add.1) dhe një tjetër për të sqaruar termat e përdorur në këtë strategji, (CEP/AC.13/2004/8/Add.2).
